REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 1770 **Prot** **Vlorë, më** 06.07.**2026**

VENDIM

Nr. 07 **, datë** 29.06.**2026**

PËR
MIRATIMIN E VENDIMIT TË KRYESISË SË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË NR. 02, DATË 14.05.2026 (NR. 1277 PROT, DATË 15.05.2026) "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË NR. 03, DATË 26.03.2025 (NR. 647 PROT, DATË 28.03.2025) "PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË NR. 18, DATË 23.09.2024 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE SHTESËS PËR POZICION TË PAGËS TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR DHE EMËRUAR, TË PUNONJËSVE CIVILË DHE ADMINISTRATIVË TË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË"

Këshilli i Qarkut Vlorë, mbledhur sot më datë 29.06.2026 në zbatim të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, nenit 15, pika 4 të Ligjit Nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 474, datë 16.06.2011 "Për përcaktimin e standarteve dhe të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nën prefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në V.K.M. Nr. 328, datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore", Ligjit Nr.

99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 80, datë 28.01.2005 "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore" si dhe Vendimit të Kryesisë së Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 02, datë 14.05.2026 (Nr. 1277 Prot, datë 15.05.2026) "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 03, datë 26.03.2025 (Nr. 647 Prot, datë 28.03.2025) "Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 18, datë 23.09.2024 "Për miratimin e strukturës organizative, klasifikimin e funksioneve dhe shtesës për pozicion të pagës të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar, të punonjësve civilë dhe administrativë të Këshillit të Qarkut Vlorë";

VENDOSI:

1. Të miratojë Vendimin e Kryesisë së Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 02, datë 14.05.2026 (Nr. 1277 Prot, datë 15.05.2026) "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 03, datë 26.03.2025 (Nr. 647 Prot, datë 28.03.2025) "Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 18, datë 23.09.2024 "Për miratimin e strukturës organizative, klasifikimin e funksioneve dhe shtesës për pozicion të pagës të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar, të punonjësve civilë dhe administrativë të Këshillit të Qarkut Vlorë" sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
2. Vendimi i mësipërm nuk do të krijojë efekte financiare shtesë për paga/sigurime për personelin e Strukturës Përgjegjëse për Inspektimin e Mbrojtjes së Tokës Bujqësore në Qark, të cilat përballohen nga buxheti i Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 78 të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Drejtore e Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Anisa Hyseni

Drejtor i Drejtorisë i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës
Benard Koço

KRYETARI
Ervis Mocka

Specialiste/Juriste
Alma Myrtaj

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web:www.qarkvlore.gov.al
E-mail:info@qarkvlore.gov.al
Tel: 00355 33 421 601